



# Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Ka ardhur koha të ndryshojmë temën. Kapitulli i ardhshëm do t'ju kushtohet matjeve në gjeometri. Në këtë kapitull do të njiheni me këndet, matjen e këndeve, perimetrat dhe sipërfaqet e katrorëve, drejtkëndëshave dhe formave të parregullta. Në fund të kapitullit do të mësoni për të famshmen Teoremë të Pitagorës,  $a^2 + b^2 = c^2$ , që përdoret me trekëndëshat kënddrejtë.



Perimetri është matje e distancës rreth një figure. Kur figura është rreth, distanca përreth quhet *perimetri i rrethit*. Për të gjetur perimetrin e një rrethi, do t'ju duhet të shumëzoni diametrin me pi. Pi ( $\pi$ ) është përafërsisht 3,14.



**Fjalor** Në këtë kapitull do ndesheni me shumë terma të rinj. Disa prej tyre mund t'i keni dëgjuar më parë.

kënd i ngushtë  
sipërfaqe  
kordë  
perimetri i rrethit  
diametër  
hipotenuzë  
veprime të anasjellta  
brinjë  
kënd i gjerë

paralelogram  
katror i përsosur  
perimetër  
pingul  
rreze  
kënd i drejtë  
trekëndësh kënddrejtë  
rrënjë katrore

## Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjeometria ndeshet kudo! Kërkojini fëmijës t'ju sjellë shembuj perimetrash dhe sipërfaqesh në jetën e vet të përditshme.